

VENDIM
Nr. 807, datë 3.12.2012

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT DHE
BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT E TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR
DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, si autoritet kontraktor, të përfundojë brenda datës 20 dhjetor 2012, realizimin e procedurave të prokurimit, me objekt “Rikonstruksion i vilës qeveritare nr. 4, Tiranë” dhe “Rikonstruksion i pjesshëm i Pallatit të Kongreseve”, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit, për vitin 2012, sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati të përfshihen shpallja e njoftimit të fituesit, lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratave të nënshkruara në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Agjencia e Prokurimit Publik dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI NR. 1

1. “Rikonstruksion i vilës nr. 4”, Tiranë, fondi limit 48.768.665 lekë me TVSH.
2. “Rikonstruksion i pjesshëm i Pallatit të Kongreseve” Tiranë, fondi limit 10.507.968 lekë me TVSH.